

Me qëllim të vlerësimit të cilësisë së shërbimeve administrative që Gjykatat Themelore të Kosovës u ofrojnë përdoruesve të gjykatave, Demokraci Plus (D+) dhe ACDC (Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike) me mbështetjen e Programit të USAID/JSSP (Programi i USAID për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë), kanë zhvilluar një studim (obzervues) përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë në tri Gjykata Themelore: Ferizaj, Mitrovicë dhe Prizren.

Studimi, i pari i këtij lloji në Kosovë, përfshin vlerësimin e 1461 përdoruesve të gjykatave, të cilët kanë kërkuar shërbime administrative në tri gjykatat themelore përgjatë tre javëve të muajit gusht të vitit 2020, ku është vlerësuar paanshmëria dhe barazia ndërmjet përdoruesve të gjykatës dhe stafit të saj, sportelit të informacionit, zyrës së regjistrimit dhe personelit të sigurisë.